



Prishtinë, 23.06.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1264_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084) - Neni 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1,
- Dispozitat e Nenit 19, të Rregullave të Tregut,
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A) për shqyrtim dhe aprovim të amendamentimit të dokumentit "Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve, të datës 12.06.2020,

në seancën e mbajtur me datë 23.06.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për amendamentimin e dokumentit "Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve" si në shtojcën e këtij vendimi.
- II. Dispozitat tjera të dokumentit "Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve" mbesin në fuqi.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.02.2020 ka kërkuar nga KOSTT Sh.A. amendamentimin e dokumentit "Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve", i cili është pjesë përcjellëse e Rregullave të tregut.

KOSTT më datë 03.03.2020 ka dërguar në ZRRE versionin e dokumentit me amendamentimet përkatëse, dhe pas komenteve të ZRRE-së ka vënë dokumentin në diskutim publik më datë 14.05.2020.

KOSTT, më datë 12.06.2020, pas përfshirjes së komenteve të palëve nga diskutimi publik, ka dorëzuar versionin final të dokumentit "Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve".



Kjo procedurë, si pjesë e Rregullave të Tregut, ka një rëndësi të posaçme dhe bënë kompletimin e Rregullave të Tregut si dhe lehtëson implementimin e tyre.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës për amandamentimin e dokumentit "*Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve*", ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Selitaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi së bashku me dokumentin *Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve* i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.